



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Monitorimi i Prokurimit Publik në Ndërmarrjet Publike: KRM Ekoregjioni, Hidroregjioni Jugor, Ndërmarrja Publike Banesore dhe Hortikultura

Korrik
2023





QEVERISJE E MIRË

AUTORË:

Ardit Dragusha
Egzona Kozhani



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Deklarata mohuese: Ky raport është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti “Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

Përmbajtja

Hyrje	7
Metodologjia	8
Furnizimi me pajisje për dixhitalizimin e faturimit dhe bizneseve për nevojat e KRM Ekoregjionit.....	9
Furnizim me material higjienik për nevojat e kompanisë - Hidroregjioni jugor	11
Vlerësimi i pronave dhe qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB)	14
Brendimi dhe dixhitalizimi - Hortikultura	18
Të gjeturat	21
Rekomandime	22

Lista e Shkurtesave

AK ➤ Autoriteti Kontraktues

DT ➤ Dosja e Tenderit

GOE ➤ Grupi i Operatorëve Ekonomikë

ISO ➤ Organizata Ndërkombëtare për Standardizim

KRM ➤ Kompania Rajonale e Mbeturive

LPP ➤ Ligji për Prokurimin Publik

NP ➤ Ndërmarrje Publike

NPL ➤ Ndërmarrje Publike Lokale

OE ➤ Operatori Ekonomik

OShP ➤ Organ Shqyrtues i Prokurimit

ShA ➤ Shoqëri Aksionare

Hyrja

Në vijim të monitorimit të prokurimit publik në ndërmarrjet publike, Demokraci Plus (D+) nxjerrë raportin e dytë për vitin 2023 ku janë përfshirë katër ndërmarrje, dy lokale dhe dy rajonale. Ndërmarrjet publike të përfshira në këtë raport mbulojnë fusha shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve, si: grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave, pastrimin e hapësirave publike, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe furnizimin e ujë të pijshëm.

Duke qenë se Ligji për Prokurimin Publik (LPP) vlen për të gjitha organizatat buxhetore duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike, andaj edhe hulumtimi i aktiviteteve të prokurimit të këtyre ndërmarrjeve është bërë bazuar në rregullat dhe përgjegjësitë që dalin nga ky ligj.

Raporti përfshinë katër tenderë të katër ndërmarrjeve publike, si: 1) furnizimin me pajisje për dixhitalizimin e faturimit dhe bizneseve për nevoja të KRM Ekoregjioni; 2) furnizimin me material higjienik për nevojat e kompanisë Hidroregjioni Jugor; 3) vlerësimin e pronave të Ndërmarrjes Publike Banesore; dhe 4) brendimin dhe dixhitalizimin e ndërmarrjes lokale Hortikultura.

Metodologjia

Hapi i parë për realizimin e këtij raporti ka qenë hulumtimi në platformën elektronike e-prokurimit përmes së cilës është bërë hulumtimi fillestar dhe zgjedhja e tenderëve. Hulumtimi është fokusuar në tenderë për të cilët procedurat e tenderimit janë zhvilluar nga muaji prill deri në qershor të vitit 2023.

Me qëllim të kompletimit të dokumenteve të nevojshme për hulumtim, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ndërmarrjet e përzgjedhura, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe mbledhjen e dokumenteve të nevojshme për monitorim.

Raporti është finalizuar me analizimin e këtyre dokumenteve, ndërsa para publikimit, raporti i është dërguar për lexim edhe autoriteve kontraktuese të përfshira në raport.

Furnizimi me pajisje për dixhitalizimin e faturimit dhe bizneseve për nevojat e KRM Ekoregjionit

Në fillim të muajit janar të vitit 2023, Kompania Regjionale e Mbeturinave (KRM) “Ekoregjioni Sh.A” në Prizren, publikoi njoftimin për kontratë për furnizim me pajisje për dixhitalizimin e faturimit dhe bizneseve me numër të prokurimit KRMP-23-78-1-2-1. Me këtë aktivitet të prokurimit synohej krijimi i kontratës publike kornizë me kohëzgjatje prej 12 muaj tekta vlera e parashikuar e kontratës ishte 55,000.00 euro.

KRM “Ekoregjioni Sh.A” shkurtroi afatin ligjor për pranimin e ofertave me arsyetimin se kishte nevojë të dixhitalizimit të shërbimeve në terren dhe se mungesa e aparaturave ishte duke shkaktuar telashe të ndryshme si faturimi i dyfishtë, ku klientët me ndryshime të vogla në emër faturoheshin dy herë apo mos dërgimi i faturave në adresa të sakta. Për këto arsye, afati minimal për pranimin e ofertave për kontrata publike me vlerë jo të madhe i cili është 20 ditë, u shkurtua në 10 ditë.

Ndonëse i shkurtuar si afat, KRM “Ekoregjioni Sh.A” nuk llogariti siç duhet as kohën e përfundimit të dorëzimit të ofertave duke e caktuar në ora 10:00 në ditën e fundit, teksa Ligji i prokurimit publik (LPP) parasheh që afati kohor shkon deri në ora 16:00 në ditën e skadimit. Sipas LPP-së¹, autoriteti kontraktues mund të vendosë të caktojë një kohë tjetër të mbylljes së afatit, me kusht që ajo të mos jetë më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit. Afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve duhet të jetë i mjaftueshëm për t’iu dhënë operatorëve të interesuar ekonomikë, kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet e kërkuara. Pra, këtë rast, shkurtimi i afatit për dorëzim të ofertave ka mundur të ndikojë në zvogëlimin e interesimit për të ofertuar.

Pastaj, në dosjen e tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, KRM “Ekoregjioni Sh.A” (autoriteti kontraktues) ndër të tjerash, kërkoi nga operatorët ekonomikë që të jenë të pajisur me tri certifikata ISO (9001, 14001, 27001). Ndonëse certifikatat ISO janë mënyrë e mirë për të u siguruar që operatorët ekonomikë aplikojnë standarde ndërkombëtare në veprimtaritë e tyre, në këtë rast, kërkimi i certifikatës ISO 14001:2015 si kërkesë profesionale, ka mundur të zvogëloji numrin e operatorëve ekonomikë të interesuar për tenderim, për faktin se kjo certifikatë nuk lidhet me natyrën e tenderit dhe veprimtarinë e operatorëve që bëjnë zakonisht këtë lloj të furnizimit. Kjo sepse ISO 14001:2015 si standard opsional, ndihmon kompanitë që të arrijnë rezultatet e synuara në krijimin e sistemeve të menaxhimit mjedisor. Ky certifikim është menduar të përdoret nga kompanitë që synojnë të marrin përgjegjësi sistematike për ambientin². Tregues për këtë është fakti se 42 operatorët ekonomikë e kanë shkarkuar dosjen e tenderit, por vetëm një (1) operator ekonomik dorëzoi ofertë.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik. Neni 5. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 11.07.2023).

2 ISO 14001:2015 Environmental management systems — Requirements with guidance for use. <https://www.iso.org/standard/60857.html> (qasur për herë të fundit me 11.07.2023)

KRM “Ekoregjioni Sh.A” ka argumentuar se arsyeja pse është kërkuar kjo ISO certifikatë është për faktin se KRM “Ekoregjioni Sh.A” është një ndërmarrje që kujdeset për ambientin, ndaj proceset e zbatimit të kontratës, pajisjet dhe servisi janë menduar të jenë në frymë të mbrojtjes së ambientit. Megjithatë, duke qenë se furnizimi kishte të bënte me pajisje të teknologjisë si printer mobil për printimin e faturave, adapter, usb kablo, kamera, softuer, etj., do të kishte qenë më e pranueshme dhe në dobi të konkurrencës në qoftë se kjo kërkesë nuk do të ishte pjesë e dosjes së tenderit, sidomos për faktin se bëhej fjalë për një afat të shkurtuar për dorëzimin e ofertave.

I vetmi operator ekonomik që dorëzoi ofertë, Solvit Sh.P.K., u shpall fitues duke nënshkruar kontratë në vlerë 44,980.00 euro.

TABELA 1. Operatori i vetëm pjesëmarrës i këtij tenderi

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Solvit Sh.P.K.,	44,980.00 euro

Kontrata mes KRM “Ekoregjioni Sh.A” dhe Solvit Sh.P.K., u nënshkrua me 06.02.2023, ndërkohë njoftimi për nënshkrimin e kontratës është publikuar në sistemin elektronik e-prokurimi dy ditë më vonë.

Ende pa u publikuar njoftimi për nënshkrimin e kontratës, pra me datën 06.02.2023, KRM “Ekoregjioni Sh.A” ka marrë vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe po atë ditë, menaxheri i kontratës, ka publikuar planin për menaxhimin e kontratës, duke bërë kërkesën e parë për furnizim me pajisje te operatori ekonomik. Po ashtu, në po të njëjtën ditë, komisioni për pranim teknik në përbërje prej tre anëtarëve ka pranuar pajisjet e kërkuara në vlerë prej 11,620 euro, duke dëshmuar nxitimin e autoritetit kontraktues në përmbushjen e kontratës.

Furnizim me material higjienik për nevojat e kompanisë - Hidroregjioni jugor

Hidroregjioni Jugor për furnizim me material higjienik për nevoja të kompanisë ka ndarë 17,953.50 euro. Në këtë aktivitet të prokurimit kanë aplikuar shtatë operatorë ekonomikë, ndërsa kontrata i është dhënë operatorit ekonomik PM Group Sh.P.K., me ofertën më të lirë në vlerë prej 7,492.50 euro. Nga kjo vërehet se kontrata është lidhur për 10,461.00 euro më pak se vlera që autoriteti kontraktues ka ndarë për këtë tender.

■ TABELA 2. Operatorët ekonomikë që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Operatori ekonomik ofertues	Çmimi i ofertës
1	Dauti Komerc Sh.P.K.	12,128.20 euro
2	Ardit Tarashaj	8,600.00 euro
3	Shaip Mustafa B.I.	8,622.00 euro
4	PM Group Sh.P.K.	7,492.50 euro
5	N.T. El -Shpëtimi	11,194.00 euro
6	Ananas Implex Sh.P.K.	12,116.79 euro
7	Kiga Sh.P.K.	7,995.10 euro

Edhe pse kemi të bëjmë me kontratë publike kornizë e cila ka kohëzgjatje prej 24 muajsh, vërehet se ka dallime të mëdha si në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës së kontratës së lidhur, ashtu edhe në mes të vlerave të ofertave të shtatë ofertuesve. Oferta me çmimin më të lartë ka qenë ajo e Dauti Komerc Sh.P.K. në vlerë prej 12,128.20 euro, ndërsa ajo më e ulta ishte e PM Group Sh.P.K. në vlerë prej 7,492.50 euro, që i bije se për furnizimin e njëjtë, ofertat dallojnë për 4,635.7 euro. Ashtu siç parashohin rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët, çmimi i ofertës fituese nuk kalon në kushtet e përcaktuara për vetëm 3,65 euro, kjo sepse te kalkulimi i çmimit mesatar të çmimi të ofertave të ofertuesve të përgjegjshëm del të mos jetë 30% më i ulët se sa çmimi mesatar. Megjithatë, gjendet në prag për tu konsideruar si tender me çmim jo-normalisht të ulët. Prandaj, siç edhe kërkohet me rregullat për tenderë të tillë, kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye tjera nga kushtet e përcaktuara, autoriteti kontraktues mund të vlerësojë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë

shpjegime në përputhje me LPP-në³. Për këtë tender, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar asnjë sqarim lidhur me çmimet, pavarësisht dallimit të madh me vlerën e parashikuar të cilën e kishin përcaktuar autoriteti kontraktues.

Në situatën ku çmimi i kontraktuar dallon shumë me çmimin e parashikuar, të shpiejnë dy rrethana: 1) autoritetet kontraktuese nuk po arrijnë të bëjnë vlerësim të duhur të çmimeve të tregut kështu duke ndarë shuma të mëdha për kontrata të tilla, ose 2) operatori ekonomik në fjalë ofron produkte nën çmimin e tregut apo me vlera jo normalisht të ulëta.

Vlera e parashikuar për një kontratë publike duhet të jetë e arsyeshme dhe reale. Për përlogaritjen e saj, autoriteti kontraktues është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut⁴ dhe vendosjen e një çmimi mesatar i cili e siguron se mund të realizoj kontratën. Se kjo analizë nuk është bërë paraprakisht vërehet edhe nga tabela 3, ku paraqiten çmimet e parashikuara për produkte të caktuara dhe çmimet e ofruara nga ofertuesit për të njëjtat produkte.

TABELA 3. Çmimi i parashikuar dhe ai i ofruar nga ofruesit për disa produkte në paramasë

Nr. i pozicionit dhe produkti i kërkuar	Çmimi i planifikuar nga AK	Operatorët ekonomikë që kanë ofertuar dhe çmimet për secilin pozicion						
		Dauti Komerc Sh.P.K.	Ardit Tarashaj B.I.	Shaip Mustafa B.I.	PM Group Sh.P.K. (fituesi)	N.T. El-Shpëtimi	Ananas – Impex Sh.P.K.	KIGA Sh.P.K.
14. Qese për mbeturina 60 litërshe (10 thasë)	1.80 euro	0.63 euro	0.30 euro	0.40 euro	0.30 euro	0.60 euro	0.60 euro	0.30 euro
16. Qese për mbeturina 150 litërshe (10 thasë)	2.80 euro	1.13 euro	0.56 euro	0.60 euro	0.55 euro	0.75 euro	1.01 euro	0.60 euro
24. Fshesë për heqjen e marimangave së bashku me shkopin	5.00 euro	3.13 euro	1.50 euro	1.50 euro	0.90 euro	2.00 euro	3.38 euro	0.80 euro
25. Gjoker me fije të gjata me bisht nga metali	3.00 euro	2.50 euro	1.50 euro	0.80 euro	0.80 euro	1.50 euro	3.38 euro	1.50 euro
29. Brushë e butë për pastrim të automjeteve me bisht metalik	5.00 euro	3.13 euro	1.60 euro	2.25 euro	1.20 euro	3.50 euro	3.90 euro	1.00 euro
33. Letër tualeti, një paketim të ketë 10 copë	5.00 euro	2.50 euro	2.20 euro	1.30 euro	1.10 euro	1.40 euro	2.10 euro	1.10 euro

³ Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët, neni 3, pika 3.2.

⁴ Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 13.1.

Për pozicionin 33 i paraqitur në tabelë, autoriteti kontraktues ka planifikuar të ndajë 5.00 euro për çdo pako. Ky çmim është shumë i lartë për këtë produkt, ku mesatarja e çmimit sipas ofertave të operatorëve ekonomikë por edhe sipas çmimit të tregut është rreth 1.67 euro, apo 3.32 euro më i ulët. Për këtë pozicion janë planifikuar të blihen 80 copë, nëse autoriteti kontraktues do të vlerësonte siç duhet çmimin e tregut, atëherë do të paguante rreth 133.00 euro dhe jo 400.00 euro sa kishte planifikuar të shpenzonte. Dallime të tilla mund të vërehen edhe në pozicionet e tjera, ku p.sh. për pozicionin 29 (brushë e butë për pastrim të veturave) autoriteti ka ndarë 5.00 euro, ndërsa çmimi mesatar i ofertave të ofruara është rreth 2.36, apo 2.63 euro më shumë. Për 30 brusha të tilla, autoriteti kontraktues do të mund të paguante rreth 78 euro në vend të 150 eurove sa janë planifikuar.

Gjatë përlogaritjes së vlerës së parashikuar, autoriteti kontraktues duhet të marrë parasysh edhe çmimet e kontratave paraprake, nëse një e tillë ekziston⁵. Në prill të vitit 2020, autoriteti kontraktues ka lidhur kontratë të ngjashme me një operator tjetër ekonomik, ku në paramasë kanë qenë disa nga produktet e kërkuara edhe me këtë tender. P.sh. në kontratën e kaluar autoriteti kontraktues ka blerë qese të mbeturinave 60 litërshe me 0.40 euro, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë të ndajë 1.80 euro për të blerë qese të tilla, apo 1.40 euro më shprehë. Nëse merret si shembull vetëm një sasi, del se është vlerë e ulët, mirëpo nëse autoriteti kontraktues do të vlerësonte çmimin e tregut apo të merrte parasysh çmimet e kontratave paraprake, atëherë në vend se të ndajë 1,820.00 euro për 1,300 copë të këtij artikulli, autoriteti kontraktues ka mundur të ndajë rreth 600 euro për të realizuar këtë blerje. Çmimi mesatar për këtë produkt ka qenë 0.44 euro sipas ofertave të operatorëve ekonomikë ofertues në tenderin e vitit 2023, që nënkupton se ka qenë krejt i përafërt me çmimin që ka blerë këtë produkt në tenderin e kaluar.

E njëjta situatë haset edhe me qeset 150 litërshe, në tenderin e kaluar për këtë artikull, autoriteti kontraktues ka paguar 0.70 euro për një copë, ndërsa në këtë tenderë ka ndarë 2.80 euro për një copë nga ky artikull, apo 2.10 euro më shumë. Çmimi mesatar i ofertave për këtë pozicion në tenderin e vitit 2023 është 0.74, krejtësisht i përafërt me çmimin e blerjes në tenderin e vitit 2020. Në total, autoriteti kontraktues në vend se të ndajë rreth 700.00 euro për të blerë 900 copë nga ky artikull, ka ndarë 2,520.00 euro, apo 1,854.00 euro më shumë.

Nëse i marrim si të shkëputura secilin pozicion duket se kemi të bëjmë me shuma të vogla, mirëpo kur merret si tërësi e gjithë kontrata, shohim se vlerat ndryshojnë shumë. Prandaj, duhet që autoriteti kontraktues gjithmonë të ketë parasysh dhe të përmbush parimin e ekonomicitetit, sipas të cilit të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike⁶.

Gjatë monitorimit të zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit nga autoriteti kontraktues, është vërejtur se ka edhe raste kur është anuluar procedura e prokurimit për shkak se nuk është bërë vlerësimi i duhur i vlerës së parashikuar, ku në këto raste vlera e parashikuar ka qenë e ulët ndërsa ofertat kanë qenë të larta. Autoriteti kontraktues për tu furnizuar me fatura rollne ka zhvilluar dy aktivitete të prokurimit, ku të dyja janë anuluar. Herën e parë ky aktivitet është anuluar sepse vlera e parashikuar ishte 850.00 euro ndërsa kishte ofertuar vetëm një operator me ofertën në çmim prej 1,400.00 euro. Ndërsa, herën e dytë ky aktivitet është anuluar sepse autoriteti kontraktues kishte marrë vendim se nuk ka operatorë ekonomikë të përgjegjshëm. Po ashtu, në vitin 2022 aktiviteti për furnizim me klor gaz dhe hipoklorit natriumi, ishte anuluar si rezultat i tejkalimit të buxhetit. Autoriteti kontraktues të njëjtin aktivitet e zhvilloi edhe në vitin 2023, dhe e anuloi për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Pavarësisht se dallimet e tilla mund të mos jenë shumë të larta nëse merret vetëm një kontratë për analizë, por kur merret në tërësi buxheti i planifikuar për tu prokuruar, sigurisht që vlerat do të jenë shumë më të larta.

⁵ Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 13.1.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 6, pika 1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 11.07.2023).

Vlerësimi i pronave dhe qirave të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB)

Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., në shkurt të vitit 2023 publikoi njoftimin për kontratë për vlerësim të pronave dhe qirave të kësaj ndërmarrje. Qëllimi i kontratës ishte vlerësimi i të gjithë pasurisë në NPB në territorin e Komunës së Prishtinës, duke përfshirë pasurinë e paluajtshme (objektet dhe tokat) dhe qiranë e këtyre pasurive. Ky aktivitet i prokurimit ri-tenderohej për shkak se tenderi i parë, i iniciuar në prill të vitit 2022, ishte anuluar në nëntor të vitit 2022.

Në tenderin e vitit 2022, NPB fillimisht kishte shpërblyer me kontratë grupin e operatorëve ekonomikë Baker Tilly Kosovo; Pro Insurance Brokers Sh.A.. Ndaj këtij vendimi, ishte ankuar CV Sh.P.K., mbi bazën se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë kishte prezantuar listën e stafit pa CV të nënshkruara dhe se ky ofertues kishte prezantuar çmimin jo normalisht të ulët. Mbi këto pretendime, NPB kishte kthyer lëndën në ri-vlerësim, ku pastaj kishte shpërblyer me kontratë Pro Acc Group Sh.P.K. Edhe vlerësimi i dytë ishte apeluar dhe lënda ishte dërguar në OShP.

TABELA 4. Operatorët pjesëmarrës në tenderin e vitit 2022

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Pro Acc Group Sh.P.K.	9,322.00 euro
2.	Baker Tilly Kosovo; Pro Insurance Brokers Sh.A..	11,800.00 euro
3.	Novaza L.L.C; KRG – Kosova Realty Group L.L.C	9,749.00 euro
4.	CV Sh.P.K	17,700.00 euro

OShP me vendimin e datës 18.08.2022, kishte aprovuar dy pretendimet ankimore të CV Sh.P.K., të cilat kishin qenë bazë për eliminimin e tij, duke hedhur poshtë arsyetimin e NPB-së dhe duke rikthyer lëndën përsëri në rivlerësim⁷. Pas rivlerësimit, NPB mori vendim të ri, ku eliminoi të gjithë ofertuesit për shkak se nuk i kishin plotësuar kriteret dhe duke anuluar tenderin. Edhe ky vendim u apelua në OShP, por i njëjti u hodh poshtë me arsyetimin se bëhej fjalë për res judicata, pra çështje që veçse ishte gjykuar njëherë duke i dhënë drejtë autoritetit kontraktues për anulimin e tenderit.

Përveç vendimit për anulimin të tenderit, NPB, në nëntor të vitit 2022 parashtroi edhe një kërkesë për diskualifikimin e operatorit ekonomik CV Sh.P.K. në OShP, me pretendimin se ky OE kishte prezantuar dëshmi të

⁷ Vendimi i Panelit Shqyrtues të OShP me nr. 231/21.

rrejshme në ofertën e tij. OShP ende nuk e ka shqyrtuar këtë kërkesë të NPB-së ndonëse kanë kaluar mbi shtatë muaj nga koha e paraqitjes⁸.

Si në procesin e parë të tenderimit në vitin 2022, ashtu edhe në ri-tenderim, vlera e parashikuar e kontratës ishte 23,600.00 euro ndërkohë afati për përfundim të kontratës në ri-tenderim u shkurtua nga 90 ditë sa ishte në vitin 2022, në 60 ditë në vitin 2023.

Për dallim nga procesi i parë ku ofertuan katër (4) operatorë ekonomikë, në ri-tenderim morën pjesë vetëm dy (2) operatorë ekonomikë.

TABELA 5. Operatorët pjesëmarrës në këtë tender

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Grupi i OE CV Sh.P.K; Vizatimi Sh.P.K.; Vlera FS Sh.P.K.; Rinor Haziri B.I	9,322.00 euro
2.	Pro Acc Group Sh.P.K.	22,900.00 euro

NPB bëri disa ndryshime në dosjen e tenderit në ri-tenderim të cilat mund të kenë ndikuar në uljen e numrit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Konkretisht, kërkesa që u vendos në ri-tenderim që operatorët ekonomikë të kenë të paktën katër (4) punëtorë të rregullt në listën e pagave në tri (3) vitet e fundit, mund të eliminojë shumë kompani të vogla/të reja të cilat e kanë të pamundur të plotësojnë këtë kriter.

Kapacitetet njerëzore të operatorëve ekonomikë mund të dëshmojnë me kontrata/parakontrata të punës me punëtorët që kanë profile të kërkuara, ndërkohë përvoja profesionale e tyre, në këtë rast tri (3) vite pas diplomimit, mund të vërtetohet duke kërkuar diplomat, kontratat e punës (ose parakontrata) si dhe referenca për përvojën e punës të lëshuar nga punëdhënësit.

Në letrën standarde për sqarimin e tenderit, NPB ka argumentuar se ky kriter është vendosur për shkak se për këtë aktivitet të prokurimit, kapacitetet njerëzore janë burimi kryesor për realizimin e kontratës, ndaj stafi i kërkuar paraqet minimumin që operatorët ekonomikë duhet ta kenë të angazhuar gjatë gjithë kohës me qëllim të realizimit të kontratës.

⁸ Në një përgjigje me e-mail të datës 07.07.2023, OShP njoftoi se është në proces të shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim në pajtim me nenin 92.2 të LPP-së, kur kanë kaluar 232 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës nga autoriteti kontraktues.

TABELA 6. Ndryshimi në dosjen e tenderit

Dosja e Tenderit	2022	2023
Kërkesa lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional	<p>Min. tetë (8) punëtorë të diplomuar ose certifikuar.</p> <p>Min. tre (3) (kontabilist) me së paku 3 vite përvojë pune.</p> <p>Min. katër (4) punëtorë të certifikuar si vlerësues me së paku 3 vite përvojë pune.</p> <p>Min. një (1) gjeodet të diplomuar me së paku 3 vite përvojë pune.</p> <p>Dëshmi se ka realizuar kontrata në vlerë 30,000.00 euro në 3 vitet e fundit.</p>	<p>Min. shtatë (7) punëtorë të diplomuar ose certifikuar.</p> <p>Min. katër (4) punëtorë duhet të jenë të rregullte në listën e pagave në 3 vitet e fundit.</p> <p>Min. dy (2) kontabilist të certifikuar me së paku tri vite përvojë pune.</p> <p>Min. katër (4) vlerësues të certifikuar me së paku 3 vite përvojë pune.</p> <p>Min. një (1) gjeodet me 3 vite përvojë pune.</p> <p>Dëshmi se ka realizuar kontrata në vlerë 30,000.00 euro në 3 vitet e fundit.</p>

Edhe në ri-tenderim, komisioni vlerësues i NPB-së mori vendim që të gjithë ofertuesit ishin të papërgjegjshëm administrativisht, duke vendosur që ky aktivitet i prokurimit të anulohet përsëri.

Grupi i operatorëve ekonomikë CV Sh.P.K; Vizatimi Sh.P.K.; Vlera FS Sh.P.K.; Rinor Haziri B.I u vlerësua se ka ofertuar me staf sekondar dhe nuk ka minimum katër (4) punëtorë të rregullt në listën e pagave në tri (3) vitet e fundit dhe se lista e projekteve të realizuara, pra kontratave nuk ishte dëshmuar me dokumente përcjellëse. Operatori tjetër, Pro Acc Group Sh.P.K., u eliminua për shkak se në listën e stafit të rregullt ishte edhe një punëtor që ishte në pushim pa pagesë si dhe licenca e gjeodetit ishte e skaduar.

NPB vlerësoi se stafi i propozuar nga grupi i operatorëve ekonomikë CV Sh.P.K; Vizatimi Sh.P.K.; Vlera FS Sh.P.K.; Rinor Haziri B.I nuk kishte dorëzuar listën e rregullt (primare) të stafit siç ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit, ku ishin kërkuar (4) punëtorë të rregullt. Në vlerësimin e NPB-së, grupi i OE-ve kishte paraqitur një punëtore si punëtore të rregullt, ndërkohë në kontratën e prezantuar, konkretisht në nenin 7-të të kontratës ishte shkruar se “e punësuar themelon marrëdhënie pune me orar jo të plotë. Orari jo i plotë gjatë ditës është 8 orë pune gjatë ditës, ndërsa 40 orë të punës në javë”. Për këtë arsye, GEO ishte vlerësuar se nuk ka ofruar dëshmi se ka minimum katër (4) punëtorë të rregullt apo primar.

Ndonëse në këtë nen të kontratës është shkruar se është “orar jo i plotë i punës”, puna prej 8 orëve në ditë dhe 40 orëve në javë konsiderohet si orar i plotë i punës në Kosovë. Sipas Ligjit të Punës, orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë⁹, ndërkohë orari jo i plotë i punës është orar pune më i shkurtër sesa orari i plotë i punës.

⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-212 i Punës. Neni 20. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735> (qasur për herë të fundit me 06.06.2023).

Në këtë rast, AK është dashur të vlerësojë përmbushjen e kërkesës (katër punëtorë të rregullt) në tersi të grupit të OE-ve, pasi kërkesat teknike/profesionale aplikohen vetëm ndaj grupit si tersi dhe jo ndaj anëtarëve individual¹⁰. Mbi paqartësinë e orarit të punës të paraqitur në kontratë, AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas Udhëzuesit për Prokurim Publik¹¹.

Edhe baza e dytë për eliminimin e këtij grupi të operatorëve ekonomikë, që kishte të bënte me përmbushjen e kontratave të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 30,000 euro, nuk ishte administruar siç duhet nga ana e NPB-së. Kjo për faktin se NPB, bazuar në nenin 72 të LPP-së, kishte kontaktuar kompanitë e paraqitura në kontrata për të konfirmuar referencat e prezantuara në ofertë, dhe pasi nuk kishte marrë përgjigje, kishte ardhur në përfundim se këto kontrata nuk ishin dëshmuar me dokumente përcjellëse valide.

Rrjedhimisht, NPB ka dal përtej autorizimeve të nenit 72, duke kontaktuar direkt kompanitë e përmendura në referenca përmes të dhënave të kontaktit, ndërkohë që është dashur që kërkesën për sqarim/plotësim të dokumenteve ta dërgojë te operatori ekonomik ofertues, siç parashihet në këtë nen. NPB keqinterpretoj nenin 72 të LPP-së, i cili flet për dokumentacionin dhe informacionin shtesë, ku iu mundëson autoriteteve kontraktuese që të mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin brenda një afati të caktuar kohor në rastet kur dokumentacioni që duhet të dorëzohet duket jo i plotë ose i gabuar, apo kur mungojnë dokumente specifike. E njëjta thuhet edhe në Udhëzuesin për Prokurimin Publik¹², i cili në raste të tilla i udhëzon autoritetet kontraktuese që të kërkojnë informata sqaruese nga operatorët ekonomikë.

Grupi i operatorëve ekonomikë CV Sh.P.K.; Vizatimi Sh.P.K.; Vlera FS Sh.P.K.; Rinor Haziri B.I, apeloj vendimin e dytë të NPB-së për anulim të tenderit në OShP, organ i cili përsëri vendosi në favor të operatorit ekonomik, duke anuluar vendimin e NPB-së dhe duke e kthyer lëndën në rivlerësim. Në ri-vlerësim, NPB përsëri i shpalli të përgjegjshëm të dy ofertuesit duke marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Edhe këtë herë, arsyet e eliminimit të dy ofertueseve ishin të njëjta sikurse herën e parë.

Vlerësimi i pronave të NPB-së paraqet një standard ndërkombëtar i cili bëhet çdo pesë (5) vjet. Herën e fundit kur NPB e kishte bërë këtë vlerësim ishte në vitin 2017, ndërkohë që tashmë kanë kaluar më shumë se 470 ditë nga njoftimi i parë për kontratë. Rëndësia për vlerësim të ri të objekteve dhe tokave që ka kjo ndërmarrje bëhet edhe më e madhe për faktin se në bazë të këtij vlerësimi, përcaktohen dhe përditësohen edhe vlerat e qirave në asetet/pasuritë që ka NPB, të cilat në vitin 2020 vlerësoheshin 83,257,803.00 euro¹³.

10 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 26.5

11 Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik. Neni 10.1

12 Po aty.

13 Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë. Raporti Vjetor 2020. https://npbanesore.com/wp-content/uploads/2021/09/NPB_raporti-vjetor-2020_preview8.pdf (qasur për herë të fundit me 11.07.2023).

Brendimi dhe dixhitalizimi - Hortikultura

Për të bërë brendimin dhe dixhitalizimin e faqes së kësaj ndërmarrje, autoriteti kontraktues “Hortikultura Sh.A.” ka ndarë 30,000.00 euro. Me këtë tender është planifikuar të ridizajnohet logo, të krijohet identiteti i ri i ndërmarrjes në bazë të fushëveprimtarisë së saj, dixhitalizimi i arkivës dhe njësive tjera operuese dhe të pasurohet me të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ndërmarrjen. Po ashtu në kuadër të këtij tenderi është planifikuar që të krijohet platforma për përdorim të brendshëm si ajo për pushime, orare, kontrata, regjistrim të mallit, etj. Në maj të vitit 2023, për këtë aktivitet është lidhur kontrata me operatorin ekonomik Safebit L.L.C. në vlerë 28,109.96 euro. Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tre operatorë ekonomikë, ndërsa oferta më e lirë ka qenë në vlerë prej 22,777.00 euro.

TABELA 7. Operatorët ekonomikë që ofertuan në këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertës
1.	GOE Prishtina Rea & Brain Inside Sh.P.K.	28,777.84 euro
2.	Safebit L.L.C.	28,109.96 euro
3.	Compass IT Sh.P.K.	22,777.00 euro

Operatori ekonomik me ofertën më të ulët është vlerësuar si i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues. Në njoftimin për vendim, autoriteti kontraktues ka sqaruar se ky operator ekonomik ka falsifikuar një dokument dhe i njëjti nuk ka përmbushur disa kërkesa lidhur me kontratat e realizuara në tri vitet e fundit sepse të njëjtat nuk kanë qenë të ngjashme me kërkesat e autoritetit kontraktues me këtë tender.

Më saktësisht, autoriteti kontraktues në këtë pikë ka kërkuar që operatori ekonomik të ketë realizuar së paku një ose më shumë kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit dhe të njëjtat duhet të arrijnë vlerën minimale prej 40,000.00 euro. Për këtë kërkesë duhet që të dorëzohet lista e kontratave që specifikon shërbimet e përfshira, shumën e kontratave, data dhe pranuesin. Kësaj liste t’i bashkangjiten dëshmitë si referenca apo certifikatë të liferimit të mirë.

Për këtë kërkesë operatori ekonomik fitues ka dërguar listën me nëntë kontrata të realizuara. Nga këto nëntë kontrata, pesë nga to në vend që të shënonin datën e lidhjes së kontratës kanë shënuar datën e lëshimit të referencës, e cila nuk jep informacionin që AK ka kërkuar. Referencat e lëshuara nga Home Concept, Mobin, Scampa e Sparkle kanë vetëm datën e referencës dhe as brenda në tekstin e referencës nuk theksohet se kur janë lidhur këto kontrata e nuk specifikohet as shuma e tyre, prandaj këto kontrata nuk do të duhej të pranoheshin nga AK. Ndërsa, referenca e Bankës për Biznes brenda në tekst ka datat e kontratave mirëpo jo edhe vlerën. Gjithsesi, kjo konsiderohet si referencë më e pranueshme se të tjerat, vlera e së cilës është 20,301.00 euro. Katër nga nëntë kontrata, kanë problemet e tyre si në vijim: kontrata me Z-mobile është e vitit 2019, që nënkup-

ton se është më e vjetër se kërkesa e AK-së; kontrata me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) është shënuar se data e kontratës është 10.12.2022, ndërsa në referencë del se kjo kontratë është lidhur në vitin 2020, më saktësisht me 06.11.2020, me kohëzgjatje prej gjashtë muajsh. Ndërsa, referenca e paraqitur si dëshmi për këtë kontratë është lëshuar me datë 10.12.2020, që i bje katër ditë pas nënshkrimit të kontratës, rrjedhimisht ende pa përfunduar kontrata. Për këtë pikë ka shumë mospërputhje në mes të datave, dhe një kontratë e tillë nuk do të duhej të konsiderohej si e pranueshme. Gjithsesi, kjo kontratë ka vlerë të ulët në krahasim me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktues. Kontrata me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) ka të bëjë me furnizim me switch¹⁴, e cila nuk paraqet kontratë të ngjashme me kërkesat e autoritetit kontraktues, pasi që me këtë kontratë janë bërë shitje të këtyre paisjeve dhe asnjë aktivitet që lidhet me brendim, ridizajnim dhe dixhitalizim. Kontrata tjetër në vlerë prej 59,738.68 euro mes OE Safabit L.L.C. dhe Storm ICT ka të bëjë me blerjen e licencave të Microsoft-it e që gjithashtu nuk është e ngjashme me kërkesat e autoritetit kontraktues pasi që me këtë kontratë janë shitur licenca por nuk është realizuar ndonjë punë që ka të bëjë me dixhitalizim dhe brendim të një uebfaqeje. Gjithashtu, për këtë kontratë është dërguar një referencë, mirëpo vërehet se kjo referencë nuk lidhet me kontratën sepse kontrata është lidhur me datë 01.03.2021 ndërsa referenca ka datën 02.12.2020 dhe me kontratë është bërë furnizimi me licenca të Microsoftit ndërsa në referencë nuk përmendet ky shërbim. Operatori ekonomik ka bashkangjitur referenca edhe për shtatë kontrata të tjera, ku vetëm një referencë për një kontratë të realizuar në vitet 2019-2020 i plotëson një pjesë të kërkesave, mirëpo kjo nuk ka të specifikuarat datat e sakta të kontratës, nuk është evidentuar në listën e kontratave të realizuara, nuk është dorëzuar kontrata dëshmi dhe më e rëndësishmja, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtesë për këto referenca siç edhe kërkohet me udhëzuesin e prokurimit publik¹⁵. Rrjedhimisht i bje se kjo kërkesë nuk është plotësuar as nga operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me stafin ku operatori ekonomik duhet të prezantoj stafin e nevojshëm prej minimum pesë personave që do të angazhohen në këtë projekt. Më saktësisht, OE-të duhet të kenë së paku një specialist IT, së paku një senior dizajner grafik, së paku një zhvillues softueri dhe të gjithë këta duhet të kenë minimum pesë vite përvojë pune. Për këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të dërgoj listën me punëtorët që do të përfshihen në këtë projekt, dhe për punëtorët specifik të kërkuar të dërgohet si dëshmi CV e tyre dhe kontrata e punës.

Mënyra se si AK ka ndarë kërkesën për listën e pesë punëtorëve dhe kërkesën për tre specialistët e tjerë, e bënë të paqartë nëse janë kërkuar tetë punëtorë, pra pesë nga lista dhe tre specialistët apo në listën prej pesë punëtorëve, tre prej tyre të jenë specialistë me kërkesat specifike. Po ashtu, fillimisht pjesë e kësaj kërkesë ka qenë që specialistët e IT-së të cilët kanë qenë të angazhuar në projekte ndërkombëtare kanë përparësi. Një kërkesë e tillë nuk është aspak relevante dhe e njëjta është larguar duke bërë korrigjim të dosjes së tenderit.

Gjithsesi, operatori ekonomik fitues ka dërguar një listë prej pesë punëtorësh, pjesë e kësaj liste është pronari i kompanisë, një zyrtar për TIK, një zyrtar administrativ, një zhvillues softueri dhe specialist i IT-së dhe një senior dizajner grafik. Për tre nga punëtorët specialist, operatori ekonomik ka bashkangjitur CV-të e tyre, por jo edhe kontratat, siç ka kërkuar autoriteti kontraktues. Për pozitën senior dizajner grafik është prezantuar CV që pohon dëshmon përvojën e kërkuar, mirëpo personi i angazhuar ka kompaninë e tij dhe nuk punon për operatorin ekonomik fitues, prandaj për të njëjtin është prezentuar parakontrata e jo kontrata siç është kërkuar nga autoriteti kontraktues. Përmes kësaj kontrate në nenin 3 tregohet se kjo kontratë është krijuar pikërisht për përfshirje në projektin për brendim dhe dixhitalizim të uebfaqes së Hortikulturës Sh.A. Për pozitën e specialistit të IT-së dhe zhvilluesit të softuerit, operatori ekonomik ka prezantuar vetëm një person që do t'i mbulojë përgjegjësitë e këtyre dy pozitave, ndërsa në dosje të tenderit është kërkuar të paktën një specialist i IT-së dhe të paktën një zhvillues softueri. Sikurse rasti paraprak, edhe ky punëtor nuk punon në kompaninë e operatorit ekonomik

¹⁴ Paisje teknologjike hardware që lidh paisjet në një rrjet kompjuterik për shkëmbim të dhënash.

¹⁵ Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Udhëzues nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, neni 10.1.

fitues por është paraqitur parakontrata për tu angazhuar në këtë projekt. Ndërsa, kontratë të rregullt ka vetëm zyrtari administrativ, në mesin e pesë punëtorëve të paraqitur në listën e stafit.

Në këtë rast, duke u bazuar në kërkesat e autoritetit kontraktues, operatori ekonomik do të duhej të dëshmonte nga një punëtor për secilën pozitë të kërkuar dhe për ta të dërgonte kontrata dhe jo parakontrata. Sjellja e parakontratave në vend të kontratave nuk do të duhej të pranohej sepse autoriteti kontraktues duhet të vlerësoj ofertat vetëm në bazë të kërkesave në dosje të tenderit. Kjo nënkupton se ky operator ekonomik nuk ka plotësuar këtë kërkesë.

Si përfundim, ky operator ekonomik do të duhej të shpallej i papërgjegjshëm dhe i njëjti nuk do të duhej të fitonte këtë kontratë.

Përveç probleme në vlerësimin e ofertave, në këtë aktivitet ka pasur edhe probleme tjera procedurale që lidhen me angazhimin e punonjësve të ndërmarrjes në procesin e vlerësimit dhe menaxhimit të implementimit të kontratës. Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, njëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave është angazhuar që të menaxhoj edhe implementimin e kontratës. Një gjë e tillë nuk është e lejuar në prokurim publik dhe bije në kundërshtim me ndarjen e detyrave në mes të personave të përfshirë, sepse një anëtarë i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i kontratës¹⁶. Kjo lejohet vetëm në rast të kthimit të rivlerësimit ku anëtarët e komisionit të kaluar të vlerësimit mund të shërbëjnë si menaxher të kontratës¹⁷. Ndarja e detyrave është shumë e rëndësishme sepse ndahen përgjegjësitë në mes të personave të përfshirë duke bërë që të ketë persona të ndryshëm në secilën fazë, e rrjedhimisht edhe të pengojë çdo mundësi ndikimi dhe shmangie të konfliktit të interesit. Prandaj, autoriteti kontraktues duhet që me përpikmëri të bëjë ndarjen e detyrave në mënyrë që të shmangë çdo mundësi të ikjes nga parimet themelore të prokurimit publik. Në sqarimin e dhënë nga AK, është thënë se kjo është bërë për shkak të numrit të vogël të stafit dhe mungesës së tyre gjatë pushimeve vjetore.

Po ashtu, pavarësisht se ky aktivitet ka qenë i paraparë me plan të prokurimit¹⁸ dhe kontrata është nënshkruar, punët për këtë projekt nuk kanë filluar sepse autoriteti kontraktues nuk ka mjete financiare për të paguar shërbimet që do të ofrohen¹⁹. Ky problem tejkalon LPP-në pasi që kemi të bëjmë me zotim të mjeteve/fondeve apo alokim të fondeve nga Thesari, procedurë të cilën e rregullon Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë²⁰, mirëpo tërthorazi prek edhe prokurimit publik. Në sqarimin e dhënë nga AK, është thënë se procesi është zgatur për shkak të procedurës së definimit të ndryshimit të emrit të ndërmarrjes, proces i cili zhvillohet në faza nga Kuvendi Komunal i Prishtinës si aksionarë të ndërmarrjes. Megjithatë, AK nuk duhet të inicioj një procedurë të prokurimit e aq më pak të nënshkruaj një kontratë nëse për të njëjtën nuk ka fonde për t'i mbuluar shpenzimet sepse me nënshkrimin e kontratës hyn në obligime kontraktuale me operatorin ekonomik. Në rastin specifik, neni 10 i kontratës së nënshkruar në mes të autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik fitues, i jep të drejtën operatorit ekonomik të ndërpres kontratën nëse autoriteti kontraktues nuk i përmbushë obligimet e veta dhe në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues do të paguaj operatorin ekonomik për humbjen ose dëmin që mund të jetë shkaktuar. Pra, një veprim i tillë duhet të shmanget në çdo rast sepse mund të shkaktoj implikime më të mëdha financiare.

16 Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 75, pika 3.7.

17 Po aty.

18 Dokument i marr nga Hortikultura Sh.A., pas kërkesës për qasje në dokumente publike të bërë më 30.05.2023.

19 Informacion i dhënë nga zyrtari i prokurimit pas takimi të mbajtur në qershor 2023.

20 Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 35. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524> (qasur për herë të fundit 11.07.2023).

Të gjeturat

KRM Ekoregjioni:

- KRM Ekoregjioni shkurtoi afatin për pranim të ofertave, pavarësisht se me ligj është përcaktuar afati kohor që duhet t'u lihet operatorëve ekonomikë për përgatitjen e ofertave.
- Përveç mos respektimit të afateve ligjore të caktuara në LPP, KRM Ekoregjioni nuk llogariti kohën e dorëzimit të ofertave siç përcakton LPP, duke caktuar orën 10:00 të ditës së skadimit si afat të fundit për dorëzim të ofertave.
- KRM Ekoregjioni ka kufizuar konkurrencën duke kërkuar një çertifikatë ISO e cila nuk është relevante me natyrën e furnizimit. Si rrjedhojë në këtë aktivitet ka aplikuar vetëm një operator ekonomik.

Hidroregjioni Jugor Sh.A.:

- Ndërmarrja publike Hidroregjioni Jugor nuk ka bërë vlerësimin e çmimit të tregut e as nuk është bazuar në çmimet e kontratës paraprake në përlogaritjen e vlerës së parashikuar.
- Ndërmarrja publike rajonale Hidroregjioni Jugor ka nënshkruar kontratë 10,461.00 euro më pak se vlera e parashikuar, si rezultat i mos analizimit të çmimit të tregut, kështu duke vështirësuar përdorimin e këtyre mjeteve në këtë vit buxhetor.

Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A.:

- Ndërmarrja Publike Banesore, pas dështimit të aktivitetit të prokurimit të vitit 2022, në aktivitetin e njëjtë të vitit 2023 ka bërë disa ndryshime në dosjen e tenderit, të cilat kanë ndikuar në uljen e numrit të ofertuesve.
- Ndërmarrja Publike Banesore ka tejkaluar autorizimin e nenit 72 të LPP-së, duke kërkuar sqarime/plotësime shtesë të informacionit nga palët e treta dhe jo nga operatori ekonomik ofertues, ashtu siç parashihet në ligj.

N.P.L. Hortikultura:

- Ndërmarrja publike lokale Hortikultura, nuk ka bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave teknike dhe profesionale që i ka caktuar kjo ndërmarrje.
- Ndërmarrja publike lokale Hortikultura, ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik që nuk ka plotësuar kërkesat në dosje të tenderit, rrjedhimisht ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.
- Ndërmarrja publike lokale Hortikultura, ka lidhur kontratë në mungesë të fondeve për të paguar shërbimet e kontraktuara. Si rezultat kontrata e nënshkruar më 28.04.2023 nuk ka filluar implementimin.
- Ndërmarrja publike lokale Hortikultura, nuk ka respektuar dispozitat ligjore për ndarjen e detyrave dhe njërin nga anëtarët e komisionit të vlerësimit e ka caktuar edhe menaxher të kontratës.

Rekomandimet:

- Autoritetet kontraktuese të respektojnë afatet ligjore siç përcakton LPP, në mënyrë që t'u mundësohet koha e nevojshme për përgatitje të dokumenteve të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar dhe kështu të sigurohet konkurrenca.
- Autoritetet kontraktuese gjatë hartimit të kërkesave të sigurohen që ato kërkesa kanë relevancë me natyrën e tenderit dhe të sigurohet se me ato kërkesa nuk po limitohet numri i ofertuesve.
- Autoritetet kontraktuese para caktimit të vlerës së parashikuar të bëjnë hulumtim të saktë të çmimeve të tregut por edhe të krahasojnë çmimet e kontratave paraprake nëse një e tillë ekziston.
- Autoritetet kontraktuese të aplikojnë rregullat e vlerësimit të ofertave të grupit të operatorëve ekonomikë siç është përcaktuar me ligj.
- Autoritete kontraktuese të shmangin lidhjen e kontratave nëse për të njëjtat nuk janë zotuar mjetet.
- Autoritetet kontraktuese të kenë parasysh ndarjen e punëve dhe përgjegjësi në një aktivitet të prokurimit dhe të mos caktojnë të njëjtin person në më shumë se një pozitë në mënyrë që të shmanget çdo mundësi keqpërdorimi.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

